

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS - SFIDAT



Pleurat Sejdiu

Kryetar i Odës së Mjekëve të Kosovës

Oda e Mjekëve të Kosovës, tash 10 vite e themeluar, kishte sfidat dhe problematikat e saj deri në arritjen e etapës vetëqeverisëse.

Rrugëtimi për themelimin e Odës së Mjekëve dhe pavarësisë apo siç njihet në konceptin modern si vetëqeverisje e mjekëve për të zhvilluar veprimtarinë e tyre, nuk ishte aspak i lehtë, por ky qëllim u arrit pas shumë sfidave dhe vështirësive dhe me ndihmën e pakontestueshme dhe vullnetin politik të qeverive të Republikës së Kosovës

Si rrjedhojë e gjendjes jo të kënaqshme në shëndetësi dhe në drejtim të zbatimit të reformave të sanksionuara me ligj, në vitin 2018 filloi bartja e kompetencave nga Ministria e Shëndetësisë dhe atë për mbikëqyrjen etike profesionale, licencimin dhe ri-licencimin dhe edukimin e vazhdueshëm profesional, të profesionistëve shëndetësorë tek Oda e Mjekëve të Kosovës.

Gjatë këtyre viteve me shumë sfida dhe vështirësi në zbatimin e ligjeve në fuqi, Oda e Mjekëve të Kosovës, përmes anëtarëve të saj, tentoi dhe u angazhua në sigurimin e standardeve të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovimin dhe mbrojtjen e veprimtarisë së profesionistëve shëndetësorë në institucionet shëndetësore publike, private, si dhe publiko-private, sigurimin dhe lehtësimin e edukimit të vazhdueshëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore.

Kontribut të jashtëzakonshëm në themelimin dhe zhvillimin institucional të Odës së Mjekëve të Kosovës ka dhënë Qeveria e Dukatit të Madh të Luksemburgut përmes projektit për shëndetësi në Kosovë, odat simotra të Gjermanisë, Kroacisë dhe së fundmi CPME – Komiteti i Përhershëm të Mjekëve të Evropës.

Hapi i parë i funksionalizimit të Odës ishte gjithsesi regjistrimi i anëtarësisë, proces i cili filloi vetëm 4 vite pas lindjes së Odës, më shkurt 2018, dhe tani numri i anëtarëve të OMK-së ka arritur në gjithsej 5299 mjekë.

Oda, gjatë këtyre viteve, ka organizuar dhe financuar 59 aktivitete me mbi 23.000 pjesëmarrës.

Përveç këtyre detyrave, OMK, përmes fushatave publike, tryezave, debateve, intervistave dhe reagimeve publike, i ka dhënë rëndësi të veçantë luftës publike kundër stigmatizimit të punëtorëve shëndetësorë dhe në veçanti mjekëve. Ky stigmatizim, këto sulme verbale e fizike dhe baltosje, janë shndërruar fatkeqësisht tanimë në fenomen.

Po ashtu, OMK, përmes potencialit të vet, u ka ofruar ndihmë dhe bashkëpunim të gjitha organeve qeveritare në drejtim të formësimit dhe zbatimit të reformave në shëndetësi, por jo vetëm.

Fatkeqësisht, jo çdo herë ka hasur në bashkëpunim dhe partneritet!

Përkushtimi i mjekut tonë tanimë është dëshmuar, me vite, me dekada, përmes sakrificave nëpër demonstrata, dënimeve dhe përndjekjes politike, luftës, dhe së fundit pandemisë, e cila edhe na i mori 21 kolegë.

Andaj, Oda e Mjekëve të Kosovës është dhe do të jetë gjithmonë në shërbim të mjekëve dhe mburojë e atyre që janë shembull i përkushtimit dhe sakrificës, i mjekëve mantel dhe faqebardhë, si pjesë e pandashme e shoqërisë dhe nevojave dhe vuajtjeve të saj.

“Ubi cumque amatur ars medica, ibi amor humanitatis”
(Kudo që dashurohet arti i Mjekësisë, ka edhe dashuri për Njerëzimin) do të thoshte Hipokrati.